

Banka e Shqipërisë

TENDENCAT NË KREDITIM T2 - 2021

*Erjona Suljoti, Olta Manjani, Anjeza Gazidede dhe Sofika Note
Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë*

KORRIK 2021

*Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk
pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

P Ë R M B A J T J A

<i>HYRJE</i>	<i>4</i>
<i>PËRMBLEDHJE</i>	<i>5</i>
<i>1. KREDIA PËR BIZNESE</i>	<i>6</i>
<i>2. KREDIA PËR INDIVIDË</i>	<i>10</i>
<i>3. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT</i>	<i>13</i>

HYRJE

Ky material synon të japë një panoramë të prirjes së aktivitetit kreditues në vend. Për të përmbushur këtë qëllim, në të analizohen të dhënat monetare, si dhe kushtet e kreditimit, bazuar në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues. Pjesë e këtij materiali është edhe një përmbledhje e zhvillimeve të fundit të aktivitetit kreditues në disa nga vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore (EQJL).

Statistikat kryesore të analizuar në material janë: a) të dhënat për aktivitetin kreditues të bankave për sektorin privat të ekonomisë; b) të dhënat cilësore të marra nga Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues (VAK); c) statistikat për normat e interesit të kredisë, si në monedhën vendase ashtu edhe në euro; d) të dhënat monetare për vëllimin e kredisë për vendet e rajonit. Vendet e përfshira në analizë janë: Bullgaria (BU), Kroacia (CR), Rumania (Ro), Serbia (Sr), Polonia (Pl), Hungaria (Hu), Republika Çeke (CZ), Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV).

Të dhënat e kredisë merren nga bilancet e bankave dhe i referohen financimit të bankave vendase për sektorin privat rezident - bizneseve dhe individëve. Analiza e portofolit të kredisë bazohet në të dhënat e kredisë të rregulluara për efektin e kursit të këmbimit dhe për kreditë e fshira nga bilanci, proces të cilin bankat e kanë ndërmarrë bazuar në vendimin nr. 50, datë 30.3.2015, "Për ndryshimin e rregullores për administrimin e rrezikut të kredisë".

Materiali mbulon të dhënat e disponueshme deri më 23 korrik 2021, të cilat përshijnë të dhënat monetare dhe financiare në vend, deri në muajin qershor 2021, dhe të dhënat e Vrojtimin të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e dytë të vitit 2021. Të dhënat e kredisë për vendet e rajonit janë deri në muajin maj 2021.

PËRMBLEDHJE


Zhvillimet në aktivitetin kreditues në tremujorin e dytë të vitit 2021 tregojnë se:

- **Kredia për sektorin privat** ka ruajtur normat e rritjes së tremujorit të parë. Përmirësimi i ritmeve të rritjes së kredisë për individë ka balancuar ngadalësimin e kredisë për biznese, duke ruajtur përgjithësisht impulsin pozitiv të aktivitetit kreditues. Zgjerimi i portofolit të kredisë ka përfitur nga një lehtësimi i standardeve të kreditimit prej bankave, si dhe nga një kërkesë në rritje për financim nga sektori privat.
- **Ecuria e kredisë për biznese** ka reflektuar ngadalësimin e kredisë për likuiditet, në kushtet e përmirësimit të aktivitetit ekonomik në vend, si dhe të pagesave të marra nga qeveria. Ndërkohë, kredia për investime ka ruajtur momentet pozitive të shënuara që nga fundi i vitit të kaluar. Sipas monedhave, kjo ecuri ka diktuar një ngadalësim të kredisë në Lek për biznese dhe mbajtjen të qëndrueshme të ritmeve të rritjes të kredisë në valutë.
- **Kredia për individë ka përsheptuar ritmet e rritjes**, duke reflektuar më së shumti përmirësimin e ritmeve të rritjes së kredisë për banesa, e cila ka shfaqur si zgjerim të kërkesës për kredi, ashtu edhe lehtësim të standardeve të kreditimit të bankave prej disa tremujorësh. Gjithashtu, në përmirësim të moderuar është shfaqur edhe kredia për konsum.
- **Normat e interesit për kreditë e reja në Lek** kanë shënuar rënie në tremujorin e dytë të vitit, si për bizneset, ashtu edhe për kreditë hipotekare për individët, në reflektim të politikës monetare lehtësuese dhe të reduktimit të primeve të rrezikut të lidhur me ecurinë e pritur të ekonomisë.
- **Bankat kanë lehtësuar kushtet e termat e kreditimit** për individët dhe i kanë mbajtur ato të pandryshuar për bizneset në tremujorin e dytë të vitit. Kjo ecuri vjen në reflektim si të reduktimit të primeve të rrezikut ashtu edhe tolerancës në rritje për të marrë përsipër rrezik.
- **Kredia për sektorin privat në rajonin e EQJL-së** shfaqet me reduktim në terma vjetorë në muajt prill dhe maj. Zhvillimet në këtë rajon janë ndikuar më së shumti nga tkurrja e portofolit të kredisë në rajonin e Evropës Qendrore. Kjo tkurrje ka prekur kredinë në segmentin e bizneseve, ndërsa kredia për individë vijon të zgjerohet.

1. KREDIA PËR BIZNESE

Kredia për biznese ka shfaqur ngadalësim të ritmeve të rritjes, duke reflektuar kërkesën më të ulët të bizneseve për kredi për financimin e nevojave për likuiditet. Në kushtet e rikthimit drejt normalitetit të aktivitetit ekonomik dhe pagesave të shtuara nga sektori publik, nevojat e bizneseve për financim kanë qenë kryesisht për kredi për investime. Bankat kanë lehtësuar standardet e kreditimit për këtë grup, duke mbështetur kërkesën për financim nga bizneset, në kushtet kur si kriteret çmim dhe ato joçmim mbeten të favorshme.

Kredia për biznese ka shfaqur ritme më të ulëta rritjeje, prej mesatarisht 7.1% në 2021T2, ose 1.1 pikë përqindje më pak se tremujori paraardhës. Tremujori i dytë i vitit është karakterizuar nga përmirësimi i aktivitetit ekonomik dhe i besimit, si dhe nga prime më të ulëta rreziku - të nxitur nga lehtësimi i kufizimeve në lidhje me pandeminë dhe menaxhimin e saj. Këto zhvillime pozitive, nga njëra anë janë reflektuar në rritjen e kërkesës për financimit të bizneseve nga bankat - kryesisht për mbështetjen e investimeve dhe me maturitete afatgjata - dhe, nga ana tjetër, kanë ndihmuar në përmirësimin e likuiditetit të bizneseve - duke ulur kërkesën e tyre për financim. Kështu, kredia për investime është rritur me 11.6% përgjatë kësaj periudhe dhe ka mbajtur normë të ngjashme me rritjen e tremujorit të parë. Ndërkohë, kredia për likuiditet shënoi ngadalësim të mëtejshëm të normave të rritjes, në 1.4%, kundrejt 3.5% të shënuar mesatarisht në tremujorin e parë. Ecuria e mirë e depozitave të bizneseve, e lidhur edhe me shlyerjen e detyrimeve për TVSH-në e rimbursueshme nga qeveria, duket se ka përcaktuar këtë dinamikë.




Sipas monedhave vihet re një rritje e qëndrueshme e kredisë në valutë për biznese, prej 4.1% vmv, e ndihmuar nga ecuria e mirë e kredisë për investime, e cila dominohet nga kreditimi në monedhë të huaj. Ndërkaq, kreditimi në Lek për biznese është ngadalësuar në 9.8%, duke reflektuar dobësinë e kreditimit për mbulimin e nevojave për likuiditet. Po kështu, ky portofol reflekton edhe përfitim më të pakët nga masat mbështetëse të marra nga qeveria, të cilat efektin e tyre më të madh e shënuan në tremujorin e dytë një vit më parë, me përhapjen e pandemisë. Në fund të muajit qershor, kredia për biznese dominohet nga kredia në valutë me 57.6%. Megjithatë, krahasuar me një vit më parë, ky nivel është 1.6 pp më i ulët, duke reflektuar zhvendosjen e portofolit drejt monedhës vendase, në përgjigje të kushteve financiare të favorshme, të cilat u lehtësuan më tej me fillimin e pandemisë.


Normat e interesit për kreditë në Lek për bizneset kanë shënuar rënie në tremujorin e dytë të vitit, në reflektim të reduktimit të pasigurive për të ardhmen dhe të një përjasjeje më pozitive të bankave ndaj financimit të sektorit privat. Edhe interesat për kreditë në Euro kanë ruajtur nivelet e ulëta të regjistruara që në tremujorin e parë të këtij viti.

Në tremujorin e dytë të vitit, bizneset kanë përfutuar financim me norma më të ulëta interesi nga bankat, pas rritjes së shënuar në dy tremujorët e mëparshëm. Norma mesatare e interesit për këtë segment rezultoi 5.4%, nga 5.8% dhe 5.6% që ishte përkatësisht në tremujorin e parë të këtij viti dhe në tremujorin e katërt të vitit të kaluar. Reduktimi i normave të interesit ka qenë veçanërisht i pranishëm në segmentin e kredive të mëdha, mbi 140 mln lekë. Norma mesatare e interesit për këto kredi rezultoi 5.2% në tremujorin e dytë, nga 5.9% që ishte në tremujorin e parë të vitit dhe 5.6% në vitin 2020. Rënie ka shënuar edhe interesi për kreditë e vogla, deri në 35 mln lekë, të cilat jepen kryesisht për bizneset e vogla dhe të mesme. Interesi mesatar për këto kredi rezultoi 5.8%, nga 6.2% që ishte një tremujor më parë. Kjo normë mbetet më lart se niveli mesatar i vitit 2020, prej 5.4%. Normat e interesit për kreditë mesatare kanë mbetur të qëndrueshme për të tretin tremujor radhazi, në 5.2%, dhe gjithashtu edhe pranë nivelit mesatar të vitit 2020.

Niveli aktual i normave të interesit të kredisë për biznese është pranë mesatares së tre tremujorëve të parë të vitit të mëparshëm (5.3%), periudhë kjo ku normat kanë qenë ndjeshëm të ulëta, si rrjedhojë e aplikimit të skemave të garancisë sovrane. Por, ndryshe nga viti i kaluar, rënia e normave reflekton tashmë një përjasje më pozitive të bankave në kreditim dhe një përcjellje më të plotë të politikës monetare, në kushtet e reduktimit të pasigurive dhe të pritshmërive pozitive për të ardhmen.



Ndikimi i politikës monetare në drejtim të uljes së normave të interesit të kredisë për biznese reflektohet qartë në analizën sipas periudhës së fiksimit të normës së interesit¹. Norma afatshkurtër e interesit – e ndryshueshme ose e fiksuar për vitin e parë të kredisë –, e cila mbart më pastër ndikim e politikës monetare në kushtet kur rreziku i kredisë nuk ndryshon, ra në 5.3% gjatë tremujorit të dytë, nga 5.7% që ishte në tremujorin e parë të këtij viti dhe në tre tremujorët e fundit të vitit të kaluar. Prej mesit të vitit 2018 e deri përpara uljes së normës bazë në fund të marsit të vitit të kaluar, niveli mesatar i saj ishte 6.2%².



¹ Periudha e fiksimit nënkupton periudhën për të cilën norma e interesit të kredisë është fikse dhe nuk ndryshon. Një kredi mund të jepet: a) me normë interesi të ndryshueshme; b) për disa periudha fikse dhe më pas e ndryshueshme; ose c) fikse, përgjatë gjithë afatit të maturimit të saj. Për qëllim të kësaj analize, norma e interesit për kreditë e dhëna me normë të ndryshueshme dhe për ato me normë fikse deri në një vit është quajtur normë afatshkurtër; ajo për kreditë e dhëna me normë fikse mbi një vit dhe deri në 5 vjet është quajtur normë afatmesme; ajo për kreditë e dhëna me normë fikse mbi 5 vjet është quajtur normë afatgjatë. Në këtë mënyrë, koncepti afatshkurtër/afatgjatë lidhet me kohën në të cilën norma e interesit të kredisë është e pandryshuar apo fikse, dhe jo me maturitetin e kredisë.


² Kjo periudhë përkton me normën bazë në nivelin 1.00%.

Nga ana tjetër, norma e interesit fikse për një periudhë afatmesme apo afatgjatë, e cila përveç pritjeve për kursin e politikës monetare në të ardhmen, mbart edhe një sërë rreziqesh, rezultoi 5.8%, duke mbetur pranë nivelit të tremujorit të parë të vitit dhe më lart se viti 2020.

Norma e interesit për kreditë në Euro të bizneseve është shfaqur e qëndrueshme në tremujorin e dytë të vitit. Ajo rezultoi 4.5%, nga 4.4% një tremujor më parë, në të cilin ajo shënoi rënie të konsiderueshme nga mesatarja prej 5.4% e vitit të kaluar. Sipas madhësisë së kredisë, rënia e normave të interesit ka vijuar edhe në këtë tremujor për kreditë e mëdha (mbi 1 mln euro), ndërkohë që është frenuar në segmentet e kredive të vogla dhe të mesme. Sipas periudhës së fiksimit, rënia është diktuar nga normat e interesit të fiksuara deri në një vit, ndërkohë që norma e fiksur për horizont më të gjatë kohor ka shfaqur një rritje të lehtë gjatë këtij viti.

Kushtet joçmim kanë mbetur të pandryshuara për bizneset për herë të parë pas disa tremujorësh shtrëngimi.

Përmirësimi i tablosë makroekonomike në vend ka gjetur reflektim edhe në politikat e kreditimit të bankave. Kështu, bankat kanë adoptuar një sjellje më pozitive lidhur me kushtet e termat e kreditimit për kreditë e reja dhënë bizneseve në tremujorin e dytë. Me lehtësimin e masave shtrënguese dhe shtimin e vaksinimit në vend, duket që janë shuar deri diku paqartësitë lidhur me pandeminë, çka i ka bërë bankat të jenë më proaktive në kreditimin e aktiviteteve të firmave në vend. Bankat vlerësuan të pandryshuara kushtet e termat e kreditimit në tremujorin e dytë, pas një shtrëngimi të vërejtur për një vit me radhë.




Në drejtim të përcaktimit të marzheve, bankat vijojnë të mbeten prudente në kreditë me rrezik, çka ka kundërbalancuar lehtësimin ndaj kredive normale. Në grupin e elementeve joçmim, shtimi i madhësisë së kredisë për bizneset duket se ka kompensuar efektin shtrëngues nga kushtëzimet më të larta në

marrëveshjet e kredive. Elementet e tjera joçmiformuese - komisionet, kërkesa për kolateral ndaj kredisë së marrë dhe maturiteti maksimal i kredisë - mbetën të pandryshuara nga një tremujor më parë.

2. KREDIA PËR INDIVIDË

Kredia për individë ka shfaqur përmirësim të normave të rritjes, duke reflektuar zgjerimin e ndjeshëm të kredisë për banesa. Me rritje shfaqet edhe kredia konsumatore, në reflektim të përmirësimit të ofertës për kredi, kushteve financiare dhe kërkesës nga individët.

Kredia për individë është rritur me rreth 9 miliardë lekë në tremujorin e dytë të vitit, duke shfaqur përshejtim të normave të rritjes, në mesatarisht 8.7%. Ky zgjerim i portofolit tregon një rikuperim të plotë të ritmeve të rritjes, të ngjashme me ato të periudhës përpara pandemisë. Zhvillimet pozitive të kredisë për individë kanë reflektuar si përmirësimin e besimit të individëve për situatën aktuale dhe të ardhme në kuadër të normalizimit të aktivitetit ekonomik, ashtu edhe rritjen e tregut të banesave. Krahas këtyre faktorëve, edhe bankat kanë vijuar të lehtësojnë ofertën për kredi për individë, si në segmentin e kredisë konsumatore, ashtu edhe në atë hipotekare. Rritja e konkurrencës së bankave në këtë segment është reflektuar edhe në kosto më të ulëta të kredisë për individë - veçanërisht të asaj hipotekare - duke mbështetur rritjen e kreditimit.




Sipas monedhës, vihet re se janë shfaqur në përmirësim si kredia në lekë ashtu edhe ajo në valutë. Kështu, norma e rritjes së kredisë në Lek u përmirësua në 10.3% dhe ajo në valutë në 5.9%³. Zgjerimi i kredisë në Lek prej më shumë se 5 vitesh dominon rritjen e portofolit të kredisë për individë. Kushtet monetare lehtësuese dhe rënia e vazhdueshme e normave të interesit duket se kanë mbështetur veçanërisht zgjerimin e shpejtë të kreditimit për banesa në Lek prej disa tremujorësh. Gjithashtu, edhe politikat aktive të ndjekura nga bankat për

³ Një tremujor më parë secili portofol shënoi një rritje mesatare përkatësisht me 7% dhe 4.5%.

uljen e ekspozimit të individëve ndaj rrezikut të kursit të këmbimit kanë vijuar të mbështesin zhvendosjen e portofolit të kredisë së individëve drejt lekut. Në muajin qershor, kjo kredi përbën rreth 65% të portofolit, krahasuar me 64% një vit më parë.

Individët kanë përfituar financim me norma më të ulëta interesi për kreditë hipotekare, si në Lek ashtu edhe në Euro. Normat e interesit për kreditë konsumatore janë shfaqur të qëndrueshme.


Norma mesatare e interesit për kreditë në Lek për individët ra në tremujorin e dytë të vitit, duke shënuar mesatarisht 6.0%, nga mesatarja e qëndrueshme prej 6.5% që ka mbizotëruar në dy vitet e fundit. Rënia e tyre është diktuar tërësisht nga normat e interesit të kredive hipotekare. Këto të fundit regjistruan nivele të ulëta në tremujorin e dytë, duke rezultuar mesatarisht 3.5%, nga 4.7% që ishin në tremujorin e parë të vitit dhe 4.4% gjatë viteve 2019 e 2020. Sipas periudhës së fiksimit të normës së interesit, rënia e normave ka qenë e pranishme kryesisht në kreditë me norma fikse të aplikuara në një horizont afatshkurtër (deri në 1 vit) dhe afatmesëm (1-5 vite). Nga ana tjetër, normat e interesit të fiksuara për afate më të gjata vijon të luhet në një interval më të lartë, në reflektim të pasigurisë që mbart fiksimi i saj. Gjithsesi, pesha e kredive të këtij segmenti në kreditë e reja hipotekare është e ulët⁴.



Interesi i kredisë konsumatore u shfaq i qëndrueshëm. Ai rezultoi 8.4% në këtë tremujor, duke mbetur i pandryshuar nga tremujori i parë i vitit dhe duke qenë pranë mesatares së vitit 2020⁵.

⁴ Mesatarisht vetëm 15% e kredisë hipotekare në Lek jepet me normë të fiksuara të interesit në një horizont kohor më të gjatë se 5 vjet.

⁵ Nëse në llogaritjen e mesatares për këtë vit përfshihet muaji prill, ku norma e interesit për kreditë konsumatore ishte ndjeshëm e ulët, ndikuar nga kreditë e një banke të sistemit.



Norma mesatare e kredive hipotekare në Euro⁶ për individë shënoi 3.2% në tremujorin e dytë të vitit, duke qëndruar pranë nivelit të regjistruar në tremujorin e parë të tij. Gjatë vitit 2021, ajo ka qenë ndjeshëm më e ulët se mesatarja relativisht e qëndrueshme prej 4.0% e dy viteve paraprijës. Diferenca mesatare e interesit të kreditës hipotekare në lekë dhe asaj në euro është ngushtuar në minimum, në 0.1 pp, gjatë këtij tremujori, nga mesatarja prej 0.6 pp e viteve të fundit.


Kushtet e termat e kreditimit në kreditë e reja akorduar individëve u lehtësuan më tej.

Bankat kanë vijuar të lehtësojnë kushtet e termat e kreditimit për individët edhe në tremujorin e dytë. Përjasja e bankave ndaj kreditimit për individët, ndryshe nga ajo për bizneset, ka qenë më lehtësuese që prej tremujorit të tretë të vitit 2020. Bankat kanë vijuar të perceptojnë rrezik të ulët, e të jenë më tolerante ndaj rrezikut në kreditë aprovuar për individët, duke përcaktuar në këtë mënyrë lehtësimin e përgjithshëm të kushteve të kreditimit për ta.

Elementet joçmim të kreditës për individët u lehtësuan nëpërmjet: (i) shtimit të madhësisë së kreditës së kërkuar; (ii) zgjatjes së maturitetit maksimal të kreditës; si edhe (iii) kërkesave më të ulëta për kolateral në raport me kredinë e marrë. Nga ana tjetër, komisionet dhe kushtëzimet në marrëveshje mbetën të pandryshuara nga një tremujor më parë.

⁶ Kredia hipotekare dominon ndjeshëm kredinë në Euro për individë, për këtë arsye analiza është përqendruar vetëm në këtë segment.

Grafik 8. Kushtet joçmim për kreditë e reja të individëve.



3. TENDENCAT E KREDITIMIT NË VENDET E RAJONIT⁷


Në muajt prill dhe maj, kredia për sektorin privat në vendet e rajonit shfaqet me reduktim në terma vjetorë. Zhvillimet në këtë rajon janë ndikuar më së shumti nga tkurrja e portofolit të kredisë në rajonin e Evropës Qendrore. Kjo tkurrje ka prekur kredinë në segmentin e bizneseve, ndërsa kredia për individë vijon të zgjerohet.

Normat vjetore të kredisë për sektorin privat në vendet e rajonit të EQJL-së kanë hyrë në territor negativ që prej muajit mars. Ky portofol ka shënuar tkurrje me rreth 0.4% në terma mesatarë vjetorë në muajt prill dhe maj, krahasuar me rënien mesatare prej 0.1% në tremujorin e parë të vitit. Pavarësisht perceptimit për përmirësim të kërkesës në Vrojtimin e Aktivitetit Kreditues në vendet e rajonit⁸ (tetor '20 – mars '21), oferta raportohet të jetë shtrënguar. Bazuar në këtë vrojtim, situata në tregjet globale dhe kreditë me probleme të grupeve të huaja bankare mbeten faktorë me ndikim negativ nga ana e ofertës.


Në terma më të detajuar gjeografikë, vërehet tkurrje e vazhdueshme e kredisë në rajonin e Evropës Qendrore. Ky portofol ka vijuar të shënojë rënie që nga fillimi i pandemisë COVID-19, duke prekur ecurinë e kredisë në segmentin e bizneseve. Ndërkohë, normat e zgjerimit të kredisë në rajonin e Ballkanit kanë vijuar të ndjekin një trajektore pozitive pas fillimit të pandemisë. Zhvillimet pozitive në këtë rajon gjatë kësaj periudhe lidhen përgjithësisht me suksesin e masave të ndërmarra në kuadër të pandemisë nga qeveritë, bankat qendrore dhe entet e tjera rregullatore.

⁷ Në këtë analizë përfshihen 9 vende të rajonit të Evropës Qendrore dhe Juglindore: Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Kroaci, Serbi, Bullgari, Rumani, Çeki, Poloni dhe Hungari. Stoku i kredisë për sektorin privat është i rregulluar për efektin e inflacionit dhe kursit të këmbimit.

⁸ Për më shumë detaje mbi vendet, bankat e përfshira dhe strukturën e VAK-ut në vendet e rajonit të EQJL-së, mund t'i referoheni adresës së mëposhtme: <https://www.eib.org/en/publications/cese-bls-2021-h1>




Kredia për biznese vijon të mbetet portofoli me kontribut negativ në ecurinë e kredisë për sektorin privat në rajonin e EQJL-së, duke reflektuar tkurrjen e tij në vendet e Evropës Qendrore. Në muajt prill dhe maj, ai u reduktua me rreth 3.3% mesatarisht në terma vjetorë, krahasuar me rënien prej 2.4% që shënoi në tremujorin e parë të vitit. Sipas Vrojimit të Aktivitetit Kreditues në rajonin e EQJL-së, standardet e kreditimit janë shtrënguar, si për korporatat dhe për SME-të, dhe priten të mbeten të tilla edhe për gjashtë muajt në vijim. Tkurria e portofolit të biznesit në disa prej këtyre vendeve lidhet, ndër të tjera, me masat e ndërmarra nga qeveria në kuadër të pandemisë, ku në vende si Polonia ka ulur kërkesën për financim nga bankat, krahasuar me periudhën para pandemisë⁹. Nga ana tjetër, portofoli i kredisë për biznese ka regjistruar norma rritjeje në përmirësim në rajonin e Ballkanit. Rritja e kërkesës për kredi nga bizneset raportuar në VAK-un e fundit të rajonit, si në segmentin e SME-ve dhe të korporatave, duket të jetë regjistruar kryesisht në këtë rajon.



⁹ Në disa nga vendet e rajonit, paketat ndihmëse të qeverisë janë konceptuar në formën e pagesave të drejtpërdrejta ndaj bizneseve.

Kredia për individë shfaq ecuri më të qëndrueshme krahasuar me portofolin për biznese. Ajo vijon të mbetet në territor pozitiv, duke shënuar rritje vjetore mesatare me rreth 1.5% në muajt prill dhe maj, nga 1.3% në tremujorin e parë të vitit. Zgjerimi i kredisë për individë në këtë rajon udhëhiqet gjithashtu nga vendet e Ballkanit, ndërsa ky portofol regjistron norma vjetore në ngadalësim në vendet e Evropës Qendrore. Sipas VAK-ut në vendet e EQJL-së, rritja e kërkesës për financim nga individët është e përqendruar në segmentin për blerje banese, ndërsa kushtet e kreditimit janë raportuar të shtrënguara si për blerje banese dhe për konsum.

Grafik 11. Kredia për individët në rajonin e EQJL-së.



Burimi: Banka e Shqipërisë; bankat e vendeve të rajonit; BEI - Vrojtimi i Aktivitetit Kreditues në vendet e EQJL-së; llogaritje të stafit.